

IRMA BILALI

**NAIM FRASHËRI DHE TITULLI I POETIT KOMBËTAR:
POLEMIKA RRETH KËSAJ ÇËSHTJEJE NË FILLIM
TË SHEKULLIT XX NË MENDIMIN LETRAR SHQIPTAR**

*Naim Frashëri, kasneci i parë i afrimit
vëllazëror. Për shqiptarët është vjershëtori që
këndoi trimëritë e të parëve dhe u shfaq
shqiptarve virtytet stërgjyshore që në kohët
më të vjetra e deri në ditët e tija.*

Asdreni

Hyrje – Naim Frashëri – poeti kombëtar i shqiptarëve

Kombet kanë përfaqësuesit e tyre të shquar në rrjedhën e historisë së ekzistencës së tyre. Çdo vend ka qendrat e veta rrezatuese, artistët e vet të shquar që shmangen nga rruga e përbashkët dhe shënojnë një traditë kombëtare. Figura e poetit kombëtar i atribuohet autorëve të cilët udhëheqin ndjenjat e masës së gjerë të lexuesve të secilës epokë. Gjithashtu ky cilësor i pranëvitet shkrimtarëve që kërkuar të rikthenin vlerat e humbura të vendit.

Një rimarrje e konceptit zë vend në romantizëm me rilindjen e poezisë dhe sentimentalizmit poetik, kur poetët fillojnë të ndjejnë nevojën për t'u hapur dhe për t'u bërë interpret të botës duke iu drejtuar atyre që kërkonin të rizbulonin vlerat e fshehura.

Titulli i poetit kombëtar është një konotacion i cili merr përdorim të gjerë kur ai shetohet në kulturën e një kombi pavarësisht dimensionit kohor. Rezultatet gnoseologjike dhe epistemologjike kanë dalë në përfundime se emri i Naim Frashërit njësohet me poetin kombëtar në numrin më të konsiderueshëm të studimeve letrare shqipe.

Më së pari një emërtim të tillë Naim Frashëri e mori si rezultat i përhapjes në një kohë të shpejtë së veprës së tij. Përpara se të shkruanin publicistët, përpara se ta analizonte kritika e studiuesit

Naimi u bë i njohur në sajë të leximit e interpretimit të vargjeve të shkruara nga dora e tij prej shqiptarëve. Ai ishte këngëtari i fateve të kombit.

*Naimi i përket si literaturës ashtu edhe lëvizjes nacionale, poeti ia mbërriti qëllimit që ta bashkojë kombin e tij, ta lartësojë në pikëpamje morale e kulturore,*¹ shprehet studiuesi ynë i shquar Eqrem Çabej.

Ai mbetet padyshim një ndër poetët që kanë lënë gjurmët të thella në historinë e kombit shqiptar si figura qendrore e njërës prej periudhave më të rëndësishme të zhvillimit të kulturës dhe shkrimit shqip, e quajtur si Rilindja Kombëtare Shqiptare. Naimi është poeti i adhuruar i të gjithë brezave, ndër më të lexuarit poetë shqiptarë. Një personalitet i kulturës dhe historisë së kombit shumëdimensional i studiuar në shumë fusha.

Miti naimian udhëton nga Veriu në Jug, nga Lindja në Perëndim, i përket të gjithëve ashtu si në çdo shkrim të tij buron dëshira për të bashkuar shqiptarët anembanë, pavarësisht se ata janë me fe të ndryshme dhe qytetërime të përkundra. Nuk do të ishte e tepruar të flisnim sot për një mitologji naimiane që përkon me një epokë historike të caktuar të jetesës së kombit shqiptar e që vazhdon të jetë e pranishme tek shqiptarët e sotëm. Në ligjërimin e përditshëm emri i Naim Frashërit është emërtimi i shumë institucioneve, shkollave, rrugëve, medaljeve e çmimeve deri te përfaqësimi i portretit në njërën nga prerjet e bankënotave shqiptare. Vëmendja ndaj kësaj figure kalon në shumë nivele të diskursit publik.

Përcaktime të tilla panegjrike e përgjithësuese gjejmë rëndom nëpër faqet e botimeve të shumta, ashtu siç ekzistojnë edhe qëndrime të përkundra e nihiliste. Përdorimi funksional i figurës së Naim Frashërit ka qenë shpeshherë pjesë e horizontit historiografik. Megjithatë për të përcaktuar saktë vendin e Naimit në letërsinë kombëtare duhet të qasemi drejt determinizmit shkencor. Naimi shihet si bartës i kulturave lindore dhe perëndimore të cilat dalin në formën e substrati në poetikën e tij.

¹ E. Çabej, *Romantizmi në Evropën lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare, Shqiptarët mes perëndimit dhe lindjes*, MÇM, Tiranë, 1994, f. 107.

Nga të dhënat që disponojmë janë mbi 100 poetë e shkrimtarë të cilët kanë shkruar vargje për figurën simbolike të Naim Frashërit². Këtyre krijuesve u shtohen emra të panumërt mendimtarësh, studiues, publicistë shqiptarë brenda dhe jashtë kufirit si dhe të huaj që shkruajnë mbi poetin shqiptar.

Për Naimin është shkruar shumë, nuk besoj se ka studiues të letërsisë shqipe që të mos i ketë kushtuar një shkrim të tij figurës së poetit. Studiuesi Shaban Sinani i cili ka kushtuar mjaft vëmendje figurës së Naimit duke e analizuar fenomenin naimian nga pikëpamje të ndryshme në një nga shkrimet shprehet “Nëse Naimi krijoi mitin e lavdisë kombëtare, për një shekull shqiptarët krijuan mitin e Naimit dhe e bënë qiriun që tretet për mbarësinë e Shqipërisë një metonimi të tij”³ e megjithatë siç vijon studiuesi “nga Naimi mbetet gjithnjë diçka për t’u thënë brezave që vijnë”⁴

Debati për poetin kombëtar në fillimshkullin e XX dhe vendi i Naim Frashërit.

Në këtë hark kohor, i cili merret në shqyrtim vihen piketat kryesore mbi studimin e figurës së Naim Frashërit. Prej këtu fillon të shfaqet së pari edhe cilësimi i tij si “poet kombëtar” e gjithashtu të artikullohet diskursi mbi këtë status si një çështje e shumëpërfolur e zhvillimeve letrare e kritike të kësaj kohe. Debati mbi nocionin e “poetit kombëtar” të shqiptarëve, i shfaqur fillimisht në këto vite, në nivele të ndryshme të ligjërimit, merr trajtat e një problemi sa nacional, sa kulturor e sa letrar. Koshienca historike ndërthuret me ndërgjegjen kulturore dhe atë letrare. Kjo gjendje përlligj edhe polemikën historike, fetare e letrare të shpalosur në librat, fletoret, revistat, gazetat e organet e tjera të kohës⁵.

² M. Gëzhilli, *Naimi 1*, Antologji poetike, Argeta – Lmg, Tiranë, 1996 (Në vëllim janë përfshirë 100 poetë me vargjet kushtuar figurës simbolike të kombit, Naimit).

³ Sh. Sinani, *Shqisë e letrarësisë shqipe*, “Midis dy rilindjesh”, Naimi, Tiranë, 2010, f. 270.

⁴ Po aty, f. 280.

⁵ Rexhep Qosja vë përballë, karakterizimet himnizuese të Luigj Gurakuqit ku Naim Frashëri është Homeri shqiptar e Milo Duçit i cili e krahason me Rabindranat Tagore përballë shkrimeve qortuese të kohës e me karakter negativ, kryesisht të Faik Konicës, në R. Qosja, *Porosia e madhe*, Shb “Naim Frashëri”, Tiranë, 1989, f. 424.

Destinacioni i veprave letrare e studimore në hapësira të shumta ku qenë shpërndarë shqiptarët lidhet me ekzistencën e një aparati kritik disaplanësh.

Në fillimshkullin XX, autoritetet e mendimit shqiptar hedhin dritë mbi jetën e Naim Frashërit, duke evidentuar momentet më të rëndësishme që lidhen me trashëgiminë e artit letrar të krijuesit. Gjithashtu fillojnë kërkimet dhe kritikën e para mbi veprën naimiane, mbi vlerat e saj artistike apo funksionin ideologjik. Mendimtarët e kohës kanë shprehur pikëpamje të ndryshme për krijimtarinë e autorit. Diskursi i krijuar prodhon pluralitet kuptimor e strukturor në disa nivele të dijes mbi letërsinë. Vendosen kështu bazat kryesore të mendimit historiografik mbi Naim Frashërin.

Jetëshkrimi i Naim Frashërit paraqitet me biografinë e Lumo Skëndos që me 1901 duke zënë kështu vend në historiografinë letrare. Reflektimi ndaj figurës së Naim Frashërit dhe veprës së tij ka vijuar me polemika të shumta në vitet `30, ku zgjojnë interes shkrimet e Konicës, Krist Malokit, Asdrenit, Safet Butkës, Norbert Joklit, Jolanda Kodrës, Kostaq Cipos, Musine Kokalarit, Nonda Bulkës etj. Mendimi i këtyre autorëve ofron sot sipas studiuesve *një lëndë të pasur studimore që për nga niveli shkencor qëndron paralel me mendimin letrar evropian të asaj kohe*⁶.

Veprimtaria kritiko-letrare e fillimshkullit XX zhvillohet me një frymë debati ndaj figurës së Naim Frashërit. Faik Konica dhe Krist Malokit janë zëra të rëndësishëm, me karakter akademik, në diskursin e ngritur në botimet publicistike. Ata shkruan dhe trajtojnë në një tjetër mënyrë figurën e Naim Frashërit duke kërkuar vlerat estetike të poezisë në përjasje me nivelin e poezisë romantike evropiane. Këndvështrimi i tyre sigurisht është i lidhur me formimin e tyre akademik dhe qëndrimin personal ndaj këtij personaliteti të rëndësishëm. Faik Konica shkroi gjithsej tre artikuj kushtuar Naim Frashërit pas vdekjes si dhe disa shkrime të shkurtra me fokus figurën e shkrimtarit dhe trashëgiminë letrare të tij. Në tërësinë e saj

⁶ E. Muhametaj, *Mendimi letrar shqiptar 1939-1944 (7)*, Qendra e studimeve albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Bota shqiptare, Tiranë 2008, f. 18.

kritika kalon përmes notave konotative e denonative. Faik Konica në shkrimet e tij kritike nuk mund të pranojë njeriun dhe shkrimtarin në dobi të njëri-tjetrit. Patriotizmi, përkushtimi ndaj atdheut të cilën ia çmon lart e ka dëmtuar aftësinë krijuese të poetit. Në këtë mënyrë ai replikon ndaj kritikave që i bëhen për opinionin e shfaqur kundrejt figurës së Naimit.

Trajtesa e studentit kosovar në Austri, i njohur edhe me pseudonimin K. Lepeteni i cili për herë të parë vë në dyshim vlerat kombëtare të veprës së Naim Frashërit ka ngjallur po ashtu polemika të shumta në kulturën shqiptare të asaj kohe dhe në vazhdimësi. Veprat e Naim Frashërit gjykohen si të përshkuara prej një *fryme ahistorike*, ku përshkrime e natyrës dhe tiparet njerëzore nuk njohin kufij kohorë, por as dhe gjeografikë. Kjo frymë sipas Malokit, ia zbeh ngjyrën kombëtare vargjeve naimiane e madje edhe karakterin arbëror figurës së Skënderbeut, edhe në mangësitë që reflektohen sipas studiuesit në strukturën ritmike të vargut me shumë përsëritje që sjellin monotoninë e poezisë. Këtyre interpretimeve Maloki i vë përballë vlerësimet e përkundërta për penën ritmike të Gjergj Fishtës ku ngjarjet historike të kombit marrin jetë në faqet e Lahutës së Malësisë.

Mendimi i Ernest Koliqit për tre poetët e mëdhenj De Rada, Naimi, Fishta merr një rëndësi të dukshme, në përvijimin e individualitetit të Naimit si një ndër poetët me vlera madhore të letërsisë shqipe që më së pari na fali dashurinë për natyrën dhe për të përcaktuar vendin e tij në këtë letërsi, si çështje e rëndësishme e historiografisë letrare shqipe.

Kostaq Cipo⁷ shprehet se është apostull i shqiptarisë dhe vëllazërisë. Autori mendon se *shqiptari nuk ka frymë nëse nuk shtije në punë frymën me të cilën është mveshur fjala e Naimit. N'ato lule dëgjohet një valle dhe e heqin poeti, apostulli, bektashiu, pantheisti, atdhetari.*

Studimi i Musine Kokalarit gjithashtu merr vlera të rëndësishme në fushën e historiografisë letrare shqipe, por dhe më gjerë. Autorja

⁷ K. Cipo, *Lulet e verës* (Mendime), Illyria, 4 Janar 1936.

ka meritën të ketë bërë të njohur përtej kufijve vlerat e Naim Frashërit si më i njohuri poet shqiptar brenda kufirit shqiptar.

Në kuadrin e historiografisë letrare vepra e Atë Justin Rrotës merr vlera specifike në evidentimin e shkrimtarëve me vlera për kombin. Autori këtu vlerëson rolin shumëplanësh të Naimit në kohën kur ai shkroi, për jehonën që la pas me veprat e tija, për prurjet gjuhësore duke përzgjedhur njëkohësisht edhe pjesë nga vepra për pjesën antologjike të botimit *Historija e Letratyrës Shqype*.

Vizioni i Çabejt si studiues filolog, historian i letërsisë e autor i të parave tekste mësimore për figurën e Naim Frashërit mbetet formë postulati siç e përmendëm dhe në krye të punimit. Në tekstin “Elemente të gjuhës dhe literaturës shqipe” vlerësohet lart figura e Naim Frashërit duke u cilësuar si apostull i idesë nacionale⁸, poeti kombëtar i shqiptarëve, figura qendrore e Rilindjes. Emri i poetit zë vend në çështjen *Literaturë* dhe bashkohet në këtë vepër me shkrimtarët e shek. XIX dhe fillimit të shekullit XX.⁹ Tek Çabej paraqitet mendimi se për krijuesit e kulturës letrare shqipe është karakteristik tipi i këngëtarit luftëtar, bartës e përhapës i idesë nacionale. Në ballë të këtyre prijësve ai vendos Naimin dhe De Radën duke i gjykuar si poetë romantikë që përpiqen të bashkojnë “*këngën (poezinë) me jetën në kuptimin e veprimit romantiko-politik në shërbim të atdheut*.”

Në vëllimin historiko-letrar “Shkrimtarë Shqiptarë” çështjet analitike mbi jetëshkrimin dhe analiza e botëkuptimit naimian është hartuar nga Filip Fishta, ndërsa për pjesën antologjike e cila paraqet fragmente të zgjedhura nga vepra e Naimit e shoqëruar me shpjegime është kujdesur Karl Gurakuqi.

⁸ Sipas Çabej gjykimi i veprës poetike të Naimi është i vështirë pasi te ky burrë apostulli dhe poeti janë një ndaj është e vështirë të bëhet ndarja e artistit nga patrioti, po aty, f. 45.

⁹ Sythi kushtuar poetit zë vend prej tre faqesh (45-48) brenda ndarjes së dytë *Literaturë* dhe në pikën Ç. *Shkrimtarët e shekullit të 19 dhe të fillimit të shekullit XX*. Po aty.

Në pjesën e parë shtrihet jetëshkrimi i N. Frashërit ku cilësohet si *vjershëtori më popullor i jugut të Shqipërisë*¹⁰.

Përfundime

Vetëdija letrare dhe historike e një kombi ecin shpesh bashkë në rrugëtimin e zhvillimit kulturor të tij. Studimet letrare ndërthurin lëndën krijuese më atë jashtëletrare duke ecur shpeshherë në linjat e studimit historiko-letrar. Në shkrimet kritike të viteve '20-40 ndiqen kritere të ndryshme që lidhen me faktorë të shumanshëm që kushtëzojnë shkencën letrare. Vërejmë se në shkrimet e viteve '20-40 dalin vlerësime nga kahe e pikëpamje të ndryshme për veprën dhe personalitetin e Naim Frashërit. Rexhep Qosja si një nga studiuesit më të vëmendshëm ndaj figurës së Naim Frashërit mendon se trajtesat e kohës *më pak a më shumë qortuese, por edhe shkrimet lavdëruese*, kanë probleme si rezultat i mosnjohjes në tërësi të veprës së poetit.¹¹

Përlavdërimet e Naimit në disa nivele si ai letrar si arsimtar si ideolog si gjuhëtar i kanë dhënë në vazhdimësi titullin e poetit kombëtar. Në këtë pikë vlerësimi bëhet simultan. Ajo që rezultoi nga shqyrtimi i Çabej vazhdon të mbetet në këndvështrimin e studiuesve si aforizëm tipik *gjykimi i veprës poetike të Naimi është i vështirë pasi te ky burrë apostulli dhe poeti janë një ndaj është e vështirë të bëhet ndarja e artistit nga patrioti*.

Naim Frashëri vazhdon t'u flasë shqiptarëve, ai shfaqet si në historinë e letërsisë, si në historinë e lexuesve, me një varg që godet duke iu afruar ndjesisë me elegancën e tingullt dhe inteligjencës sonë me një të vërtetë që vetëm liria personale e secilit mund të zgjedhë ta vlerësojë seriozisht.

¹⁰ K. Gurakuqi, *Shkrimtarët Shqiptarë 2*, Rilindja, Histori e Letërsisë Shqipe, Nën kujdesin e Ernest Koliqit, Pakti, 2008, f. 20.

¹¹ R. Qosja, *Porosia e madhe*, Shb "Naim Frashëri", Tiranë, 1989, f. 425.

